



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj. Themeltar 2634 (31138-02709-80)
Data e Regjistrimit 04.05.2021

Nr.Vendimi 2922 (80-2021-2983)
Data e vendimit 25.10.2021

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga:

Eriol Roshi Gjyqtar

Asistuar nga sekretare gjyqësore Etleva Kristo, në Tiranë, sot më datë 25.10.2021, ora 12:30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura të çështjes administrative nr. 2634 akti, regjistruar më datë 04.05.2021, që i përket:

PADITËSE: Rajmonda Tafa, e bija e Evanthisë dhe Spiros , e dtl. 14.03.1955, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan, me adresë Rr: “Aqif Pasha”, përfaqësuar në gjykim nga Av.Andi Skenderi me i Dhomës së Av. Tiranë me adresë Rr “ Rruga e Barrikadave”, Qendra Turdiu Kt 6, Tirane.

IPADITUR: Qendra Kombëtare e Biznesit, përfaqësuar në gjykim nga Jorina Bushaj, Malvina Sinani dhe Romena Qamo.

PERSONA TË TRETË: Xhemile Myftiu, banues në lagjen 5 Maj, Elbasan, në mungesë.
Jalldyz Dhaskali, banues në Rr. Barrikadave, Tiranë, në mungesë.

Avokatura e Shtetit ka deleguar të drejtën e përfaqësimit dhe mbrojtjes.

OBJEKTI: Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ kthim përgjigje shkresen Nr 2209/1, datë 16.03.2021 të Qendrës Kombëtare të Biznesit si e pa bazuar në ligj.

Detyrimin e organit publik Qendra Kombëtare e Biznesit të kryejë veprimin administrativ të refuzuar duke korrigjuar aplikimin me nr CN-660878-00-21 date 17.02.2021 për shoqëritë KLENTI-AM SHPK me NIPT L23201202M; aplikimin CN-662088-02-21 për shoqërinë “REFRAKTARE” SHA me NIPT J 62903317E; aplikimin CN-660874-02-21 për shoqërinë “Uzinë Mekanike KME” SHA me

nIPT J62903216N; në lidhje me pasqyrimin e saktë të pjesëve takuese nga dëshmia e trashëgimisë Nr 83 Rep dhe Nr 31 kol date 30.01.2021 pjesen trashëgimore të Edmont Tafa në lidhje me përqindjen që zene në aksione trashëgimtare.

BAZA LIGJORE: Nenet 7/b; 15/a 17/c i Ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative” Nenet 154 - 158 e vijues të K.Pr.Civile, Nenet 349 e vijues të Kodit Civil dhe Nenet e K.Familjes 73 e vijues.

Gjykata si dëgjoi përfaqësuesin e paditësit që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, si dëgjoi përfaqësuesin e të paditurit që kërkoi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova, në mungesë të personave të tretë, pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Se paditësja Rajmonda Tafa ka paraqitur përpara kësaj Gjykate një kërkesëpadi me palët, objektin dhe bazën ligjore që tregohen në pjesën hyrëse të vendimit gjyqësor .

Palët ndërgjyqëse, përveç personave të tretë, janë paraqitur në gjykim, i padituri ka dorëzuar prapësime sipas nenit 25/1/b të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative” i ndryshuar, ndërsa personat e tretë nuk janë paraqitur në gjykim.

Rrethanat e çështjes:

Rezulton nga aktet provuese të paraqitura në gjykim se paditësja Rajmonda Tafa ka qenë e martuar me shtetasin Edmond Tafa provuar ky fakt me çertifikatën e Martesës së Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan të datës 28.04.2021. Shtetasi Edmond Tafa, ka ndërruar jetë jashtë shtetit në Stamboll, Turqi në datën 14.10.2020.

Paditësja ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore përpara noterit publik Resmie Ruçi e cila ka lëshuar Dëshminë e Trashëgimisë ligjore Nr. 83/31 , sipas së cilës dhe në zbatim të nenit 360 të K.Civil, si trashëgimtarë ligjorë të të ndjerit janë përcaktuar Rajmonda Tafa (bashkëshortja) dhe të motrat e tij , personat e tretë në këtë gjykim, Xhemile Myftiu dhe Jalldyz Dhaskal, me arsyetimin se për sa kohë që bashkëshortët nuk kanë fëmijë nga martesat e tyre. Pjesët takuese nga pasuria trashëgimore janë : Rajmonda Tafa ½ pjesë, Xhemile Myftiu ¼ dhe Jalldyz Dhaskali 1/4 pjesë.

Rezulton po kështu se shtetasi Edmond Tafa zotëronte i 50% të kuotave të Shoqërisë “KLENTI-AM”, SHPK me NUIS L23201202M, 13.75% të aksioneve të shoqërisë “REFRAKTARE”, SHA, me NUIS J62903317E dhe 2.624 % të aksioneve të shoqërisë “UZINA MEKANIKE KME”, SHA, me NUIS J62903216 N.

Paditësja ka aplikuar në QKB për regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë me aplikimet duke pretenduar regjistrimin në këtë mënyrë : 6/8 pjesë të kuotave paditësja dhe 1/8 personat e tretë .

Ndërkohë pala e paditur në rastin e Shoqërisë “KLENTI –AM” SHPK ka pasqyruar kuotën që i takonte të ndjerit , në këtë mënyrë: Raimonda Tafa, 25% , Xhemile Myftiu 12.5% dhe Jalldyz Dhaskali 12.5% .

Në shoqërinë "REFRAKTARE" SHA, me NUIS J62903317E, pasqyrimi i kuotave të ortakeve, nga ana e QKB është bërë si vijon: 13.75% Rajmonda Tafa dhe 3.437 Xhemile Myftiu dhe Jalldyz Dhaskali,

Ndërsa në Shoqërinë "UZINA MEKANIKE KME", SHA, pasqyrimi i kuotave, nga ana e QKB është bërë 1/2 për paditësen dhe 1/4 për personat e tretë.

Në këto kushte, paditësja ka aplikuar, për korrigjimin e të dhënave në datën 26.02.2021 për korrigjim gabimi për shoqërinë Uzina Mekanike me NIPT J62903216N për çështjen me nr CN-665752-02-21.

Po kështu, me datë 26.02.2021 paditësja, ka aplikuar për korrigjimin e Shoqërisë "KLENT-AM" me NIPT L23201202M për çështjen me nr CN-665733-02-21 si dhe më datë 26.02.2021 ka aplikuar për korrigjimin e shoqërisë "Refraktare" SHA me NIPT J62903317E; për çështjen me CN-665745-02.21.

Pas aplikimit për korrigjimin si më sipër, në datë 16.03.2021 nga ana e Qendres Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr 2209/1, paditëses i është dërguar shkresa: "Kthim Pergjigje" ku thuhet se, Gjykata citon: "Nga sa kemi sqaruar më sipër regjistrimi i të dhënave pranë regjistrimit tregtar është kryer bazuar në deshmimin e trashëgimisë ligjore në përputhje me procedurën ligjore të parashikuar në nenin 54 të ligjit nr. 9723/2007. Ndërkohë nëse keni pretendime për masën e kuotës që duhet të zotërojë Znj.Raimonda Tafa sqarojmë se këto pretendime nuk janë objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga QKB por duhet të paraqiteni përpara organeve kompetente."

Më pas paditësja i është drejtuar gjykatës me kërkesë padi me objekt dhe palë si më lart.

Pretendimet e paditëses:

Referuar kthim përgjigjes së QKB-së Nr 2209/1 Prot., datë 16.03.2021 vlerësojmë se ka një qëndrim të gabuar sa i takon faktit se ndarja është bërë e saktë për shkak se punonjësi i QKB vlerëson në mënyrë formale aktin e trashëgimisë. Ky vlerësim formal nuk duhet të lejohet nga ana e palës së paditur që të prodhojë paligjshmëri edhe për faktin se Kodi Civil është ligj dhe është i detyrueshëm për zbatim dhe nga organet publike siç vepron dhe Agjensia Shtetërore e Kadastrës kur i paraqitet një deshmimi trashëgimie duke ndarë pjesët takuese në mënyrë të saktë gjë të cilën nuk e ben institucioni i QKB edhe pse nuk ka një dispozitë urdheruese për mos të vlerësuar pjesët takuese.

I ndjeri ka qenë ortak në tre shoqëritë e sipercituara të cilat janë krijuar gjatë martesës. Këto shoqëri janë krijuar gjatë regjimit martesor ndaj në këto kushte kuotat dhe aksionet e trashëguara nuk mund të pjesëtohen në mënyrë të barabartë me trashëgimtarët e rradheve të treta sic ka vepruar gabim QKB deri më tani me leximin e akteve të depozituara nga ana e jone ndaj në këto kushte do kërkonim që sa kohë nuk ka një organ më të lartë referuar kjo dhe në kthim përgjigjen e QKB që të ishte gjykata ajo që të mund të detyronte organin publik QKB për të pasqyruar saktë këto të dhëna që ndikojnë në përqindjen e saktë që duhet të zotërojë secili mbajtës i kuotës.

Duke mos u respektuar saktë dispozitat e Kodit Civil nga ana e organit publik QKB është krijuar një situatë cenimi pasuror duke u cënuar pjesët e bashkepronësive, ku ligji parashikon se bashkëshortja në çdo rast merr automatikisht 1/2 dhe pjesa e cila nuk cënohet dhe pjesa që mbetet do t'i nënshtrohet pjestimit në raport me përqindjes që rezultojnë dhe me rradhën trashëgimore përkatëse nga celja e deshmisë që në rastin tone është 1/4 për trashëgimtarët e rradhës së tretë që matematikisht kanë 1/8 pjesë dhe 6/8 i zotëron bashkëshortja e të ndjerit.

Në këto kushte, vlerësojme se duhet që gjykata të detyrojë organin publik QKB të pasqyrojë saktë të dhënat e dëshmise se trashgimise duke përcaktuar kështu po saktë raportin e përqindjes që zënë realisht në shoqëri trashgimtare e ish ortakut te shoqërive tregtare.



Prapësimet e palës së paditur:

Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Biznesit, janë të mirëpërcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 131/2015, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", në të cilin ndër të tjera përcaktohet se QKB është institucioni përgjegjës për regjistrimin e subjekteve dhe të dhënave pranë regjistrit tregtar si dhe informimin e paleve të interesuar lidhur me të dhenat e regjistruar pranë saj.

Sa me sipër, QKB është një organ administrativ i cili shqyrton aplikimet dhe aktet bashkelidhur pa u ndalur në shqyrtimin e përmbajtjes së tyre dhe verifikimin e saktësisë, vërtetësisë apo ligjshmerise se këtyre akteve. Nëse pas verifikimit të kryer, rezulton se aplikimi është në përputhje me kërkesat e ligjit, nëpunësi i autorizuar vendos miratimin e aplikimit, duke pasqyruar pranë regjistrit tregtar ndryshimin e të dhënave të kërkuara.

Lidhur me pretendimin e pales paditese per korrigjimin e aplikimeve, me nr. CN-660878-02-21, nr. CN-662088-02-21 dhe nr. CN-660874-02-21, pasi subjektet "KLENTI-AM", shpk, me NUIS L23201202M, "REFRAKTARE", SHA, me NUIS J62903317E dhe "UZINA MEKANIKE KME", SHA, me NUIS J62903216N, janë krijuar gjatë martesës së të ndjerit z.Edmond Tafa dhe Raimonda Tafa, ndaj duhet të merren në konsideratë dispozitat e Kodit të Familjes, sikunder është zbatuar nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme. ju bejme me dije se referuar ligjit nr. 9723/2007, regjistrimi i të dhenave pranë regjistrit tregtar ka karakter deklarativ me efekt publikimin dhe njohjen e të tretëve lidhur me të dhënat e regjistruar pranë saj, pjesë e së cilave janë të dhënat lidhur me gjendjen e ortakërisë/aksioneve. Nderkohe, bazuar sa me sipër, në rast se do të kryhej interpretimi i dëshmisë së trashëgimisë, se kuota/aksioni i të ndjerit, përfshihet në regjimin e bashkësisë ligjore, atëherë si rrjedhojë do të çënohej karakteri deklarativ i regjistrimit.

Është jashtë tagrit ligjor të QKB-se, të interpretoje mbi ligjshmerine e këtyre akteve apo të regjistroje të dhenat përtej çfare është urdheruar në aktet që deponohen në aplikim.

Ndaj, për sa kemi sqaruar më sipër, regjistrimi i të dhenave pranë regjistrit tregtar është kryer bazuar në dëshminë e trashëgimise ligjore, në përputhje me procedurën ligjore të parashikuar në nenin 54, të Ligjit nr. 9723/2007. Për sa më sipër, kërkojmë rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Vlerësimi i Gjykatës:

Në lidhje me sa më sipër, Gjykata çmon se padia e paditëses Rajmonda Tafa është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet.

Neni 74 i K.Familjes parashikon se : "Bashkësia përbëhet nga:a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë; ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.

Në rast se veprimtaria tregtare para lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve, por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët, bashkësia përfshin vetëm fitimet dhe shtimin e prodhimit”.

Ndërsa neni 76 i K. Familjes parashikon se : “Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”.

Nga përmbajtja këtyre dispozitave të tillë, Gjykata vlerëson se për sa kohë palët nuk kanë zgjedhur regjimin martesor të ndryshëm nga ai i bashkësisë, atëhere pasuria e vendosur gjatë martesës është në regjimin e bashkësisë ligjore dhe pjesët prezumohen si të barabarta. Në këtë kuptim, në rastin kur lëshohet dëshmia e trashëgimisë ligjore në favor të trashëgimitarit bashkëshort i trashëgimlënësit, fillimisht duhet veçuar pjesa takuese nga bashkësia ligjore, dhe mbi pjesën e mbetur të zbatohen rregullat e trashëgimisë ligjore.

Jo pa qëllim ligjvënësi , e ka prezumuar këtë bashkësi edhe në rastin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të bashkëshortëve.

Fakti që ligji për QKB nuk e ka një parashikim të tillë, nuk të do të thotë që të mohohet e drejta e bashkëshortit pasjetues për një pjesë më të madhe për shkak të bashkësisë ligjore.

Në rastin e përplasjes së normave juridike të përcaktuar në ligje , për përcaktimin e normës së zbatueshme , doktrina juridike ka vendosur parimin se ligji i miratuar më vonë shfuqizon ligjin e mërpashëm qoftë edhe në mënyrë të heshtur ose se do të zbatohet ligji specifik mbi atë të përgjithshëm.

Por në rastin konkret normat që përplasen janë ato të një ligji i cili është kod pra, sipas nenit 81/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë miratohet me një shumicë të cilësuar prej 3/5 dhe një ligji si ai 9723/2007 “ Për QKB” i cili miratohet me një shumicë të thjeshtë, Në këtë rast praktika kushtetuese ka përcaktuar përparësinë e normave juridike të vendosura në kode ndaj ligjeve të miratuara me shumicë të thjeshtë.

Neni 109 gërma d e K.Pr.Administrative parashikon se : “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:... d) është në kundërshtim me ligjin material”.

Neni 40/1 , a i ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, parashikon se : Gjykata, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë, vendos: a)shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrative”

Për sa më sipër Gjykata çmon se padia e paditëses Rajmonda Tafa është e bazuar në ligj dhe prova, për këtë arsye duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata pasi pa nenin 126 të K.Pr.Civile dhe nenet 40-42 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

VENDOSI

1. Pranimin e padisë së paditëses Rajmonda Tafa.
2. Konstatimin e paligjshmerise se veprimi administrativ kthim pergjigje Nr. 2209/1 date 16.03.2021 te Qendres Kombetare te Biznesit.
3. Detyrimin e organit publik Qendra Kombetare e Biznesit te kryeje veprimin administrativ te refuzuar duke korrigjuar aplikimin me nr CN-660878-00-21 date 17.02.2021 per shoqerite KLENTI-AM sh.p.k me NIPT L23201202M; aplikimin CN-662088-02-21 per shoqerine REFRAKTARE sh.p.k me NIPT J 62903317E; aplikimin CN-660874-02-21 per shoqerine

Uzine Mekanike KME me nipt J62903216N; duke pasqyruar pjesët takuese sipas dëshmisë të trashëgimisë.

4. Shpenzimet gjyqësore të përbëra nga tarifa mbi aktet dhe shpërblim të përfaqësuesit të palës paditëse, në masëm 43.000 lekë i ngarkohen palës së paditur.
5. Vendimi përbën titull ekzekutiv kur merr formë të prerë dhe ekzekutohet Zyra Përmbartimore përkatëse për ekzekutimin e tij. Ekzekutimi i vendimit bëhet menjëherë sapo të vihet në ekzekutim.
6. Kundët këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot në Tiranë, më datë 25.10.2021.

SEKRETARE

Etleva Kristo


GJYQTAR

ERIOL ROSHI

Vendimi mori formë të prerë pasi
nënk e arsyetuar me dt 16.05.2022
Tiranë me dt 19.05.2022

K / SEKRETARE
SELVANA GOGO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr. Regj.Them 70 (31136-03147-80-2023)

Datë. Regj.20.04.2023

Nr. vendimi s'ka

Datë vendimi 16.06.2023

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me trup gjykues të përbërë prej :

GJYQTARE : GENTIANA MUÇAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore Kristjana Thana , në Tiranë, sot më datë 16.06.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. **70 (31136-03147-80-2023)** Akti, që i përket :

KËRKUESE: Qendra Kombëtare e Biznesit . përfaqësuar me anë të autorizimit nr 10775/1 prot datë 30.05.2023 nga znj Elda Guni.

PERSON I TRETË: RAjmonda TAfa e bija e Evanthisë dhe e Spiros drl 14.03.1955 lindur dhe banuese në Elbasan me adresë rruga "Aqif Pasha" .

-Xhemile Myftiu banuese në lagjen "5 Maji " Elbasan në mungesë.

-Jalldyz Dhaskali banuese në Rrugën e Barrikadave Tiranë në mungesë.

OBJEKTI: Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021.

BAZA LIGJORE: Neni 314 i K.Pr.Civile,

Në përfundim të hetimit gjyqësor të çështjes, të zhvilluar në prani të përfaqësueses të palës kërkuese Qendra Kombëtare e Biznesit dhe të personit të tretë Rajomnda Tafa dhe në mungesë të personave të tretë Xhemile Myftiu dhe Jalldyz Dhaskali të cilat kishin

dijeni dhe pa shkaqe të arsyeshme nuk u paraqitën në seancë gjyqësore , Gjykata ; pasi degjoi pretendimet perfundimtare të palëve ndërgjygjëse të cilët kërkuan :

-Përfaqësuesja e palës kërkuese Qendra Kombëtare e Biznesit : pranimin e kërkesës sipas objektit.

-Personi i tretë Rajmonda Tafa : rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në prova dhe në ligj.

si dhe pasi analizoi provat e paraqitura nga palët dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN SE:

Kërkuesja Qendra Kombëtare e Biznesit ka paraqitur përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë një kërkesë me objekt Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021.

Gjykata, bazuar në nenin 36 të Kodit të Procedurës Civile, konstatoi kryesisht se kjo çështje bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe bazuar në nenin 314 të K.Pr.Civile si dhe në nenet 7, 10/1 dhe 11/2 të ligjit nr. 49/ 2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është kompetente nga pikëpamja lëndore, funksionale dhe tokësore për shqyrtimin gjyqësor të saj.

Bazuar në parashikimet e nenit 12/1 të ligjit nr. 49/ 2012 ‘ Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’i ndryshuar, çështja u mor në shqyrtim nga trup gjykues i përbërë nga një gjyqtar.

Bazuar në parashikimet e nenit 79/a të K.Pr.Civile, kërkesë padia dhe aktet ju njoftuan dhe Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila, ia delegoi të drejtën e përfqësimit dhe mbrojtjes organit administrativ.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi që:

Me vendimin nr. 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur:

-Pranimin e kërkesë padisë së paditëses Rajmonda Tafa

-Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ kthim përgjigje nr 2209/1 prot datë 16.03.2021 të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

-Detyrimin e organit publik Qendrës Kombëtare të Biznesit të kryejë veprimin administrativ të refuzuar duke korrigjuar aplikimin m enr CN-660878-00-21 datë 17.02.2021 për shoqëritë Klenti –Am shpk me NIPT L23201202M , aplikimin CN-

662088-02-21 për shoqerinë refraktare shpk me NIPT J62903317E . aplikimin CN-660874-02-21 për shoqerinë Uzina Mekanike KME me NIPT J62903216M duke pasqyruar pjesën takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë.

-Shpenzimet gjyqësore të përbëra nga tarifa mbi aktet dhe shpërblimin e përfaqësuesit të palës paditëse në masën 43 000 lekë i ngarkohen palës së paditur .

-Vendimi përbën titull ekzekutiv kur merr formë të prerë dhe ekzekutohet nga zyra përmbartimore përkatëse për ekzekutimin e tij, Ekzekutimi të bëhet menjëherë sapo të vihet në ekzekutim/

-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Pala kërkuese Qendra Kombëtare e Biznesit më datë 20.04.2023 ka paraqitur pranë kësaj gjykate një kërkesë ku kërkon sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës administrative të Shkallës së PArë Tiranë .

Përfaqësuesja e palës kërkuese pretendoi gjatë gjyqimit se me vendimin nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së PArë Tiranë është vendosur korrigjimi i aplikimeve ku ndryshohen kuotat dhe përqindjet në kapital të trashëgimtarëve ligjorë në subjektin Klemti-M shpk, Refraktare sha dhe Uzina Mekanike KME sh.a .Lidhur me këtë përcaktim nga ana e palës kërkuese ka paqartësi mbi përqindjet përfundimtare të kapitalit që duhet të regjistrojë /korrigjojë në regjistrin tregtar për secilin trashëgimtar të subjekteve të sipërcituara.

Pala e tretë Rajmonda Tafa prapësoi se vendimi 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është i qartë dhe nuk ka asnjë lloj paqartësie .Pala e paditur duhet ta zbatojë këtë vendim ashtu siç përcakton diapozitivi i tij. Ajo është trashëgimtare e bashkëshortit të saj në të gjitha pasuritë e lëna prej tij në ½ pjesë ndërkohë që këto pasuri janë të krijuara gjatë martesës ku ajo është bashkëspronare në ½ pjesë të pasurisë.

Gjykata, duke pasur parasysh pretendimet dhe prapësimet e palëve, provat e paraqitura si dhe parashikimet ligjore, çmon se kërkimi i kërkueses Qendra Kombëtare e Biznesit është i pabazuar. Në vijim po parashitrojmë argumentet:

Së pari neni 314 paragrafi 1 dhe 2 i kodit të procedurës civile parashikon : Gjykata ka të drejtë të japë sqarime ose të bëjë interpretimin e vendimit që ajo ka dhënë kur ky është i errët dhe e kërkojnë palët.

2.Kërkesa për sqarimin dhe interpretimin e vendimit mund të paraqitet në çdo kohë, gjersa vendimi nuk është ekzekutuar.

Gjatë gjykimit rezultoi se me anë të vendimit nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur :

Pranimin e kërkesë padisë së paditëses Rajomda Tafa

-Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ kthim përgjigje nr 2209/1 prot datë 16.03.2021 të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

-Detyrimin e organit publik Qendrës Kombëtare të Biznesit të kryejë veprimin administrativ të refuzuar duke korigjuar aplikimin m enr CN-660878-00-21 datë 17.02.2021 për shoqëritë Klenti –Am shpk me NIPT L23201202M, aplikimin CN-662088-02-21 për shoqërinë refraktare shpk me NIPT J62903317E, aplikimin CN-660874-02-21 për shoqërinë Uzina Mekanike KME me NIPT J62903216M, duke pasqyruar pjesën takuese sipas dëshmisë së trashëgimisë.

-Shpenzimet gjyqësore të përbëra nga tarifa mbi aktet dhe shpërblimin e përfaqësuesit të palës paditëse në masën 43 000 lekë i ngarkohen palës së paditur .

-Vendimi përbën titull ekzekutiv kur merr formë të prerë dhe ekzekutohet nga zyra përbarimore përkatëse për ekzekutimin e tij, Ekzekutimi të bëhet menjëherë sapo të vihet në ekzekutim/

-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar

Nga pjesa arsyetuese e këtij vendimi rezulton se gjykata ka arsyetuar si vijon :

“Neni 74 i Kodit të familjes parashikon se : Bashkësia përbëhet nga : a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët së bashku ose veç e veç gjatë martesë, , b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkëshorti gjatë martesës nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë, c) frytet e pasurisë së çdo bashkëshorti që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësië, ç) veprimtaria tregtare krijuar gjatë martesës .

Në rast se veprimtaria tregtare pas lidhjes së martesës i përkiste vetëm njërit prej bashkëshortëve por gjatë martesës drejtohet nga të dy bashkëshortët bashkësia përfshin vetëm ditimet dhe shtimin e prodhimit”

Ndërsa neni 76 i Kodit të familjes parashikon se : Pasuria e bashkëshortëve prezumohet se i e përmbashkët me përjashtim rë rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak Nga përmbajtja e këtyre dispozitave , gjykata vlerëson se përsa kohë palët nuk kanë zgjedhur një regjim martesor nga ai i bashkësisë atëherë pasuria e vendosur gjatë martesës është në regjimin e bashkësisë ligjore dhe pjesët prezumohen si të barabarta. Në këtë kuptin në rastin kur kërkohet lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore në favor të trashëgimtarit bashkëshort i trashëgimlënësit fillimisht duhet veçuar pejsa takuese nga bashkësia ligjore dhe mbi pjesën e mbetur zbatohen rregullat e trashëgimisë. Jo pa qëllim ligjvënësi e ka prezumuar këtë bashkësi edhe në rastin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në emër të bashkëshortëve. Fakti që ligji për QKB nuk e ka një parashikim të

tillë nuk do të thotë se të mohohet e drejta e bashkëshortit pasjetues për një pjesë më të madhe për shkak të bashkësisë ligjore. Në rastin e përplasjes së normave juridike të përcaktuar në ligje për përcaktimin e normës së zbatueshme doktrina juridike ka vendosur parimin se ligji i miratuar më vonë shfuqizon ligjin e mërrparshëm qoftë edhe në mënyrë të heshtur ose se do të zbatohet ligji specifik mbi atë të përgjithshëm Por në rastin konkret normal që përplasen , janë ato të një ligji i cili është Kod pra sipas nenit 81/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë miratohet me një shumicë të cilësuar 3/5 dhe një ligji si ligji nr 9735/2007”Për QKB” i cili miratohet me shumicë të thjeshtë.

Në rastin konkret gjykata cmon se vendimi nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk është i errët në arsyetimin e tij pasi ai ka argumentuar bashkësinë në kuptim të dispozitave të kodit të familjes si dhe ka argumentuar pse duhet të zbatohet në rastin konkret Kodi i familjes përse i përket pasurisë së krijuar gjatë martesës. Pra personi i tretë Rajomnda TAfa përveç trashëgimtare e bashkëshortit të saj Edmond Tafa të cilin e trashëgon në ½ pjesë të pasurisë (çdo lloj pasurie qoftë e paluajtshme qoftë e luajtshme) është dhe bashkëpronare për shkak të martesës në pasurinë krijuar së bahsku me bashkëshortin e saj gjatë martesës .Kjo pasuri prezumohet në pjesë të barabarta sipas nenit 76 të Kodit të Familjes .

Pra pala kërkuese Qendra Kombëtare e Binzesit duhet të zbatojë vendimin nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë jo vetëm duke lexuar diapozitivin e saj por duke e lexuar të gjithë vendimin duke përfshirë dhe pjesën arsyetuese të saj me qëllim kuptimin e zbatimit të urdhërimeve të vendimit 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Po kështu rezultoi se pala kërkuese Qendra Kombëtare e Binzesit nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë , çka do të thotë se ajo është e qartë dhe ka kuptuar vendimin nr nr 2922 (80-2021-2983) datë 25.10.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 314 i K.Pr.C, i cili parashikon se “Kundër vendimeve të mësipërme mund të bëhet ankim i veçantë sipas rregullave të përgjithshme”, kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçante ne Gjykatën Administrative te Apelit Tiranë, brenda 5 diteve,duke filluar afati nga e nesermja e komunikimit te vendimit.

Në përfundim, duke pasur parasysh gjithë sa më sipër u citua, gjykata çmon se kërkesa e kërkueses Qendra Kombëtare e Biznesit është e pabazuar ne ligj dhe prova dhe si e tillë duhet rrëzuar nga ana e gjykatës.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 40, 41 të ligjit nr. 49/ 2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar

VENDOSI :

- Rrëzimin e kërkesës së kërkueses Qendra Kombëtare e Biznesit si e pabazuar në prova dhe në ligj
- Shpenzimet gjyqësore sic jane bere.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, më 16.06.2023

SEKRETARE

KRISTJANA THANA



GJYQTARE

GENTJANA MUCAJ



Vendimi mori forme të prerë pasi
nuk u ankimua me dt
Tirane me dt

K / SEKRETARE
SELVANA GOGO



DATE 30/01/2021

NR REP 83

NR KOL 31



A2021010460003272455

**LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE**

Sot ne Elbasan më date 30.01.2021 (tridhjetë janar dymijë e njezet e nje) une notere Resmie Sh. RUÇI, Anetare e Dhomes Kombetare te Notereve , Dega Vendore Durrës e me zyre noteriale ne Elbasan me adrese ne -Lagjen "5 Maj", Rruga "Fetah Ekmekciu", Elbasan, mora në shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin që i përket :

KËRKUESES:

Raimonda Tafa, atësia Spiro, amësia Evanthi, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në ELBASAN, me adresë Aqif Pasha 00910003; Nd. 3; H. 1; Elbasan; Elbasan; 3001; Elbasan, lindur më 14/03/1955, gjendja civile "e ve", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 030722675 dhe nr. personal F55314002A .

OBJEKTI:

Lëshimi i dëshmisë së trashëgimise ligjore për trashëgimlënësin Edmond Tafa, atesia Ali, amesia Shkendi lindur ne Elbasan me date 13.01.1954, me shtetesi shqiptare e gjendje civile - i martuar , e vdekur me date 14.10.2020.

BAZA LIGJORE:

Nenet 316, 317, 318, 318/1, 318/2 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 320,322, 326, 327, 330, 331, 332, 333 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 341, 342, 343 te ndryshuar , neni 348 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 360, 361 ,362, 363, 364 e vijues te Kodit Civil te ndryshuar , si dhe nenet shtuar e ndryshuar sipas Ligjit Nr. 121/2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 7850 date 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës se Shqipërisë", te ndryshuar.

Nenet 111, 112, 113, 121, etj te Ligjit Nr. 110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine"

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, unë Noteria , bazuar në nenet 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e shërbimit Noterial, të Zyres Noteriale Elbasan, territor mbi të cilën shtrin kompetencën zyra ime noteriale Resmie Ruçi për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte, ne perfundim te shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentacionit ligjor e me kerkesen e kerkueses, e cila me kerkoi pranimin e kerkeses sipas objektit te saj, une noteria :

KONSTATOJ

Se kërkuesia Raimonda Tafa eshte bashkeshortia e te ndjerit Edmond Tafa dhe ka paraqitur kerkesë per leshimin e dëshmise se trashëgimise ligjore te bashkeshortit te saj , ndaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile dhe Nenit 121 te Ligjit Nr. 110/2018 date 20.12.2018 "Per



A2021010460003272455

Noterine”, ajo ka interes te ligjshëm në këtë kerkim, pra legjitimohet të paraqesë kërkimin para kësaj zyre noterie per leshimin e deshmise se trashëgimise ligjore te trashëgimlënesit Edmond Tafa. Gjithashtu zyra ime noteriale Elbasan, në bazë të Nenit 111 , pika a, te Ligjit Nr. 110/2018 date 20.12.2018 “Per Noterine”, dhe Nenit 348 te Kodit Civil te ndryshuar ka kompetencën vendore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit rezulton të ketë qenë në Bashkinë e Elbasanit .

Nga informacioni i marre zyrtarisht nga une noterja me date 27.01.2021 prane Dhomes Kombetare te Notereve per Regjistrin Kombetar te Testamenteve , nepernejt sistemit elektronik NIO.SA, rezulton se trashëgimlënesi *Edmond Tafa* nuk ka disponuar me testament gjate gjalleses se tij si dhe nuk ka kërkesa te meparshme per celje trashëgimie dhe per kete arsye eshte aprovuar dhe konfirmuar kërkesa per leshimin e deshmise se trashëgimise ligjore te tij.

Per rrjedhoje, sot une noterja në bazë të nenit 317 te Kodit Civil te viti 1994, te ndryshuar , ne Ligjin Nr.121 dt. 18.04.2013 “ Per disa shtesa dhe Ndryshime ne Kodin Civil te Republikes se Shqiperise”, te ndryshuar si dhe ne Ligjin Nr. 110/2018 date 20.12.2018 “Per Noterine”, procedoj me leshimin e deshmise se trashëgimise ligjore te trashëgimlënesit duke percaktuar rrethin e trashëgimtareve ligjore dhe pjeset e tyre takuese.

Për kete arsye ,une noteria i referohem nenit 318 të Kodit Civil te ndryshuar, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësës dhe pjesët takuese të secilit, bën të zbatueshëm ligjin e kohës se çeljes së trashëgimisë, referuar rregullimit ligjor në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit leshuar nga zyrat e gjendjeve civile, rezulton e provuar se: më datë 14.10.2020 ka vdekur trashëgimlënësi *Edmond Tafa* ,atesia Ali, amesia Shkendi lindur ne Elbasan me date 13.01.1954 ,me shtetesi shqiptare e gjendje civile – i martuar e me vendbanim te fundit ne Lagjen "Aqil Pasha",Elbasan, fakt që vërtetohet nga çertifikata e tij e vdekjes leshuar me datë 27.11.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile e Njesise Administrative 092, Bashkia Elbasan.

Ne rastin konkret eshte i zbatueshem ligji nr.7850 datë 29.7.1994 « Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë » me ndryshimt perkatese dhe meqenëse nga hetimi nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë disponuar pasurinë e saj me testament, në bazë të nenit 317 te Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore duke iu referuar neneve 360 e 361 te Kodit Civil. Neni 361 i Kodit Civil aktual, përcakton në paragrafin e parë të tij si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin «*Në radhë te parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta....*

Kur njeri nga femijet ka vdekur para trashëgimlënesit, eshte bere i padenje per te trashëguar, ka hequr dore nga trashëgimi, ne vend te tij hyjne me zevendesim femijet e tij dhe kur per shkaqet e mesiperme nuk mund te jene trashëgimtare, vijne ne trashëgim te paslindurit e tyre pa kufi. Ne kete rast pjesa e prindit qe nuk trashëgon, ndahet ndermjet te paslindurve ne pjese te barabarta.

Kur pervec bashkeshortit nuk ka trashëgimtare te tjere te radhes se pare, ne trashëgim thirren ata te radhes pasardhese te parashikuara nga Neni 363 te ketij Kodi dhe kur nuk ka te tille, thirren trashëgimtarete e radhes pasardhese te parashikuara prej nenit 364 te ketij Kodi.

Ne cdo rast bashkeshorti merr 1/2 pjese te trashëgimit . Kur nuk ka trashëgimtare te rradheve te mesiperme, trashëgimi i mbetet bashkeshortit pasjetues».

Nga dokumentacioni i paraqitur vertetohet se i ndjeri *Edmond Tafa* ka patur nje martese, ate me shtetasen *Raimonda Tafa*.



A2021010460003272455

Sipas certifikates se martesës leshuar me date 25.11.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile Rrethi Elbasan, rezulton se me date 04.01.1982 e me nr. Akti 4 i ndjeri *Edmond Tafa*, ka lidhur kete martesë ligjore me shtetasen *Raimonda Tafa (Nikolla)* me atesi Spiro, amesi Evanthi lindur ne Elbasan me date 14.03.1955 e sot banuese ne Lagjen « Aqif Pasha », Elbasan, identifikuar me numer personal F55314002A.

Nga kjo martesë sipas certifikates se tringut familjar me gjendje te viteve 1950-1974 te leshuar me date 25.11.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile Rrethi Elbasan dhe certifikatave te tringut familjar me gjendje te viteve 05.01.1982 leshuar me date 07.12.2020 nga Zyra e Gjendjes Civile 96, Elbasan dhe te viteve 1990 ;2009 ;2010 ; 2020 te leshuara nga Zyra e Gjendjes Civile ZGJ92, Bashkia Elbasan, nuk kane lindur femije.

Gjithashtu nga dokumentacioni ligjor i paraqitur nga kerkuesia nuk rezulton qe trashegimlenshi te kete patur femije jashte martesë apo dhe te femije te biresuar (referuar Nenit 362 te Kodit Civil).

Referuar Nenit 361 te Kodit civil, meqenese trashegimlenshi Edmond Tafa nga martesë e vetme me shtetasen Rajmonda Tafa nuk ka patur femije e pervec bashkeshortes nuk ka trashegimtare te tjere ligjore te radhes se pare te cilet do te trashegonin sipas neneve 361 dhe 362 te Kodit Civil, atehere ne trashegim thirren ata te radhes pasardhese te parashikuar nga Neni 363 i Kodit Civil dhe kur nuk ka te tille, thirren ne trashegim trashegimtare e radhes pasardhese te parashikuar ne Nenin 364 te ketij Kodi.

Pra, ne kete rast, pervec bashkeshortes, e cila trashgon 1/2 pjese te pasurise trashegimore (Neni 361 i Kodit Civil) thirren ne trashegim si trashegimtare ligjore trashegimtare e radhes pasardhese, pra ata te radhes se dyte, radhes se trete, etj sipas percaktimeve te bera ne Nenin 363 dhe Nenin 364 e vijues te Kodit Civil.

Keshtu, Neni 363 i Kodit Civil aktual, percakton si trashegimtarë ligjorë të radhës së dyte prinderit e trashegimlenshit me formulimin: *«Në radhë te dyte thirren në trashëgim prinderit e trashegimlenshit dhe persona e paafte per pune, te cilet 1 vit para vdekjes se trashegimlenshit, bashkejetonin me ate si anetare te familjes dhe ne ngarkim te tij.»*

Ndersa Neni 364 i Kodit Civil percakton: *«Ne radhe te trete thirren ne trashegim personat e paafte per pune ne ngarkim te trashegimlenshit qe permenden ne Nenin 363 te ketij Kodi, kur nuk ka trashegimtare te tjere te radhes se dyte, gjyshi, gjyshja, vellezerit dhe motrat si dhe femijet e vellezerve e te motrave te paravdekur. Te sipermit trashegojne ne pjese te barabarta, pa u bere dallimi ndermjet vellezerve e motrave te nje ati ose vetem te nje nene, ndermjet gjyshit e gjyshes nga ana e babes ose e nenes.»*

Nga te gjitha certifikatat e paraqitura rezulton e provuar se prinderit e trashegimlenshit jane: *Ali Tafa*, me atesi Selim e amesi Xhemile lindur ne Elbasan me date 06.01.1919 dhe vdekur me date 22.08.1977 dhe

Shkendi Tafa, me atesi Abdyl dhe amesi Rukije lindur ne Elbasan me date 14.02.1926 e vdekur me date 29.09.2009;

te cilet kane lidhur martesë ligjore me njeri -tjetrin me date 24.03.1948 me numer akti 43 e provuar kjo me certifikaten e martesës date 25.11.2020 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Rrethi Elbasan.

Nga kjo martesë ata kane lindur 3(tre) femijet:

1. Edmond Tafa, atesia Ali, amesia Shkendi, lindur Elbasan me date 13.01.1954 e vdekur me date 14.10.2020.



2. **Xhemile MYFTIU**, atesia Ali amesia Shkendi lindur Elbasan me date 01.11.1955 e banuese ne Lagjen " 5 Maj", Elbasan gjinia-F, shtetase shqiptare me gjendje civile – e martuar, identifikuar me nr. personal F56101175K

3. **Jalldyz DHASKALI**, atesia Ali amesia Shkendi lindur Elbasan me date 28.08.1958 e banuese ne Njesine Bashkiake Nr. 2, Tirane gjinia-F, shtetase shqiptare me gjendje civile – e martuar, identifikuar me nr. personal F85828038T.

Gjithashtu provohet se , *te dy prinderit e trashegimlensesit jane te paravdekur, pasi ata kane vdekur perpara tij*, konkretisht babai Ali Tafa ka vdekur me date 22.08.1977 dhe nena Shkendi Tafa ka vdekur me date 29.09.2009.

Referuar Nenit 363 te Kodit Civil, dhe nga të gjitha certifikatat e administruara nga une noterja, rezulton se trashegimlensesi nuk ka trashegimtare te radhes se dyte, pasi prinderit e tij jane te paravdekur dhe ne ngarkim te tij nuk ka patur persona te paafte per pune.

Per kete arsye meqenese trashegimlensesi nuk ka trashegimtare te rrades se dyte, ne trashegim do te therriten trashegimtares te radhes se trete sipas menyres se percaktuar ne Nenin 364 te Kodit Civil, pra ne trashegim do te therriten gjyshi , gjyshja, motrat e vellezerit e tij .

Nga sa me sipër e duke u bazuar ne Nenin 364 te Kodit Civil , e nga certifikatat e administruara nga une noteria , rezulton se : *gjysherit nga ana e babait* , te quajturit *Selim Tafa*, atesia Ali, amesia Shegush lindur ne Elbasan me date 06.12.1882 dhe *Xhemile Tafa* , atesia Dyl Furxhiu, amesia Zeliha e dtl. 1901 jane te paravdekur (pasi kane vdekur para trashegimlensesit, perkatesisht me date 06.12.1982 dhe 22.09.1929) dhe *gjysherit nga ana e nenes* , te quajturit *Abdyl Bishqemi*, atesia Isak, amesia Vule i dtl. 28.02.1900 dhe *Rukije Bishqemi*, atesia Qerim, amesia Adile e dtl. 30.07.1905 jane te paravdekur , perkatesisht me date 08.05.1984 dhe 04.02.1976, *ndersa dy motrat e tij Xhemile Myftiu dhe Jalldyz Dhaskali jane gjallë edhe sot, ndaj kane qenë gjallë në kohën e vdekjes së trashëgimlensesit e si të tilla keto te fundit përfshihen në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së trete të tij.*

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e mësipërm të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate, apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia .
- Gjithashtu nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë pasur martesë të tjera, as të ketë pasur fëmijë jashtë martese, apo të birësuar.
- Nga kontrolli ne Rregjistrin Kombetar te Testamenteve, konfirmohet nga Dhoma Kombetare e noterise se trashegimlensesi nuk ka lene testament.
- Kerkuesia me deklaroi se nuk ka trashegimtare te tjere ligjore, pervec atyre te pasqyruar ne trugun familjare dhe te pasqyruar ne certifikatat e lindjeve te depozituara prej saj.

Për sa më lart, ne baze te Nenit 361 te Kodit Civil, trashëgimtare ligjore e radhes se pare e trashegimlensesit Edmond Tafa eshte bashkeshortia tij dhe trashegimtare ligjore te radhes se trete referuar Nenit 364 te K.Civil jane dy motrat e tij. Pra, trashegimtare ligjore te trashegimlensesit Edmond Tafa jane perkatesisht shtetaset:



1. Raimonda Tafa
2. Xhemile Myftiu
3. Jalldyz Dhaskali

- bashkeshortia, e cila trashëgon 1/2 pjese te pasurise trashëgimore
- e motra , e cila trashëgon 1/4 pjese te pasurise trashëgimore
- e motra, e cila trashëgon 1/4 pjese te pasurise trashëgimore



A2021010460003272453

të cilët e trashëgojne të gjithë pasurinë trashëgimore te trashëgimlensesit duke mbartur ne kete menyre te gjitha te drejtat dhe detyrimet e saj në raport me pjeset takuese qe ato trashëgojne.

Shpenzimet noteriale te përcaktuara nga urdheri Nr. 306 date 31.07.2013, janë në ngarkim te trashëgimtareve ligjore dhe përbëhen nga ato për paraqitjen e kërkesës dhe leshimin e trashëgimise ligjore, paguar në masën 10.000 lekë pa TVSH.

PËR KËTO ARSYE

Une notere Resmie Ruçi ,bazuar ne Nenet 316, 317, 318, 318/1, 318/2 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 320,322, 326, 327, 330, 331, 332, 333 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 341, 342, 343 te ndryshuara , neni 348 te Kodit Civil te ndryshuar, nenet 360, 361, 362, 363 e 364 e vijues te Kodit Civil te ndryshuar , si dhe nenet shtuar e ndryshuar sipas Ligjit Nr. 121/2013 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 7850 date 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikes se Shqiperise", te ndryshuar.

Nenet 111, 112, 113, 121, etj te Ligjit Nr. 110/2018 date 20.12.2018 "Per Noterine".

VENDOSA

Pranimin e kërkesës se kerkueses .

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlensesin **Edmond Tafa**, atesia **Ali, amesia Shkendi** lindur ne *Elbasan me date 13.01.1954, me shtetesi shqiptare e vdekur me date 14.10.2020*, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasat:

1. **Raimonda Tafa** - bashkeshortia ,qe trashëgon **1/2 pjese**
2. **Xhemile Myftiu** - e motra , qe trashëgon **1/4 pjese**
3. **Jalldyz Dhaskali** - e motra , qe trashëgon **1/4 pjese**

Te drejtat dhe detyrimet e trashëgimlensesit mbi te gjitha pasurite trashëgimore u kalojne trashëgimtareve te lartpermendur ne raport me pjeset takuese qe ata trashëgojne.

Ne perputhje e ne respektim te detyrimeve ligjore qe parashikon Ligji Nr. 110/2018 date 28.12.2018 "Per Noterine", ky Vendim rregjistrohet ne Rregjistrin Kombetar te Dëshmive te Trashëgimise prane Dhomes Kombetare te Noterise.

Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 6(gjashte)fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëra depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve te tjere ligjorë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ENKELEIDA I. HOXHA



V2021053570024287150

DATE 17/02/2021
NR REP 368

VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN

Sot, më datë 17/02/2021, para meje Noteres **ENKELEIDA I. HOXHA**, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Lagjia NR.5, Rr. BLV"BAJRAM CURRI", GODINA 1 MAJI, AP. NR.22, HYRJA 3, u paraqit personalisht:

KËRKUES:

Jalldyz Dhaskali, atësia Ali, amësia Shkëndi, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banues në TIRANË, me adresë Fadil Rada; Nd. 1; H. 3; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 28/08/1958, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 036018328 dhe nr. personal F85828038T, e cila me paraqiti dokumentat si me poshte vijon:

Vendim Per Leshimin e Deshmise se Trashegimise Ligjore me Nr. 83 Rep. dhe Nr. 31 Kol., date 30.01.2021.

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësini penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja "i", nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë"; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

